



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:261595

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05504922

E.nr.279/2009

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Vushtri – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtarin Naim Rekaliu, në çështjen juridike përmbartimore të të K. me seli në Prishtinë kundër debitorit A.H nga fshati Smrekonicë, Komuna Vushtrri, lidhur me propozimin për ekzekutim të borxhit, jashtë seancës me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET i tërhequr propozimi me numër E.nr.279/2009, i kreditorit K. me seli në Prishtinë, kundër debitorit A.H nga fshati Smrekonicë, Komuna Vushtrri, lidhur me propozimin për ekzekutim të borxhit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Kreditori K. me datë 24.03.2009, pranë kësaj gjykate ka paraqitur propozim për ekzekutimin e borxhit.

Gjykata me konkluzionin E.nr.279/2009 i datës 16.02.2024 e ka obliguar kreditorin që në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimi të këtij konkluzioni të bëjë plotësimin e propozimit për përmbartim, gjegjësisht të precizojë shumën dhe periudhën për të cilën kërkohet borxhi ndaj debitorit dhe gjykatës t'ia dërgoj ekstraktin e verifikuar nga librat afaristë, në origjinal apo kopje

të vërtetuar, konkluzion të cilin kreditorit e ka pranuar me datë 01.03.2024, mirëpo i njëjti nuk e ka plotësuar propozimin brenda afatit të caktuar në konkluzion.

Meqenëse kreditori nuk e ka bërë plotësimin e propozimit dhe precizimin e kredisë për debitorin A.H brenda afatit të paraparë, gjykata vendosi që propozimin e tij të paraqitur pranë kësaj gjykate ta konsideroj të tërhequr.

Andaj, bazuar në të lartcekurat e konform nenit 102 par. 3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

E.nr.279/2009, datë 26.03.2024

Gj y q t a r i
Naim Rekaliu

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.